

Sulejman Ahmedi, PhD¹

UDC: 368:336.76]:616.98:578.834}-036.22(497.7)

**TREGU I SIGURIMEVE I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT NË PERIUHDHËN E PANDEMISË GLOBALE COVID-19**

**ПАЗАР НА ОСИГУРУВАЊЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА
МАКЕДОНИЈА ВО ВРЕМЕ НА ГЛОБАЛНАТА ПАНДЕМИЈА
СОВИД-19**

**INSURANCE MARKET OF THE REPUBLIC OF NORTH
MACEDONIA DURING THE GLOBAL PANDEMIC COVID-19**

Abstract

As a result of the global pandemi COVID-19, financial markets experienced significant fluctuations where the insurance market was one of them and as a result has been the subject of research in many projects and research papers. Therefore and in line with what was said above this The paper will address the insurance market developments in the Republic of North Macedonia.

The insurance market in this circumstance did not remain immune to the effects and possible negative consequences and therefore the purpose of this paper is to analyze the development of the insurance market for the period 2020 compared to 2019, in some cases and several years ago.

From the analyzes made at the beginning, we emphasize that in 2020 there was an economic contraction, the reduction of gross domestic product by 2.3% is one of the indicators. Gross written premium for 2020 decreased by 4.89% compared to the previous year, 2019. In particular in some classes as auto liability we have a decrease in gross

¹ Fakulteti juridik, Universiteti i Tetovës

written premium by 9.6% and at the same time a decrease of 8.7% in gross claims liquidated in yes the same class. At the same time another class analyzed is the tourist aid which had a decrease of 65% in the gross written premium.

The limitation of this is research the time period, as the Covid-19 virus and its impact has not ended and continues to affect even after the completion of this research. This work leaves space to be updated in the future.

Keywords: COVID-19, insurance market, impact, security

Hyrje

COVID-19, virus i cili u shfaq në fund të vitit 2019 dhe më pas u shndërrua në një pandemi globale, ka ndikuar në jetën e njerëzve në mbarë globin. Sektorët financiar nuk ishin të pa prekur dhe pandemia shënoi ndryshime në punën e tyre, qoftë pozitive apo negative. Vazhdimisht janë ngritur shqetësime se si do të reagoj tregu i sigurimeve, si do të ndikoj në aftësinë paguese të kompanive të sigurimit, e kështu me radhë. Siç thuhet në një kumtesë nga EIOPA² “Sektori i sigurimeve duhet të merret me kushtet sfiduese të tregut dhe të mbajë operacionet, duke mbrojtur në të njëjtën kohë punonjësit dhe mbajtësit e policave”.

Kjo periudhë e cila po vazhdon akoma, ishte dhe është akoma një sfidë për të gjitha bizneset dhe për të gjithë biznesbërësit. Mjedisi i pasigurt i sfidoi bizneset për fleksibilitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Duke operuar në një mjedis të rrezikshëm, dhe në pasiguri për kohëzgjatjen e kësaj gjendjeje, shoqëritë e sigurimeve duhet që të kujdesen të ruajnë kapitalin, për këtë ka pasur dhe sugjerim drejtuar tyre nga Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimeve. Sugjerimi drejtuar tyre ishte që të kenë kujdes në shpërndarjen e dividendës në fund të vitit, me qëllim të ruajtjes së kapitalit.

Gjatë periudhës së pandemisë, ajo që u vendos më shumë në dukje ishte nevoja e digjitalizimit. Për shkak të masave të ndryshme kufizuese të vendosura nga udhëheqësia e shtetit me të vetmin qëllim që të mund të kontrollohet shpërndarja e virusit, digjitalizmi ishte shpëtues për shumë biznese e konsumatorë. Ato biznese që patën fleksibilitetin të

² Përgjigjja e EIOPA ndaj krizës së Corona virusit –
https://www.eiopa.europa.eu/media/speeches-presentations/interview/eiopa-response-coronavirus-crisis_en

zhvendosin sistemin e tyre të punës mbijetuan dhe korrën mjaft sukses. “Ajo që po shohim – dhe kjo nuk është vetëm për sektorin e sigurimeve – është se si teknologjia digjitale po bëhet më thelbësore, më e disponueshme dhe më normale. Kjo do të vazhdojë edhe pas zhdukjes së pandemisë”- thuhet në vazhdim nga EIOPA - Autoriteti Evropian i sigurimeve dhe pensioneve profesionale. Ato më tej vazhdojnë duke dhënë këshillë që të ruhen nga sulmet kibernetike, pasi që ky dhe është kërcënimi më i madh i digjitalizimit. “Duhet të jemi gjithashtu të kujdesshëm, ne duhet të sigurohemi që digjitalizimi i shtuar nuk i vë njerëzit në një rrezik më të madh ndaj mashtrimit, krimit kibernetik ose përjashtimit financiar. Prandaj, politikëbërësit dhe mbikëqyrësit duhet të kërkojnë të ofrojnë mjedisin e nevojshëm për të mbështetur këtë transformim duke zbutur rreziqet në zhvillim”.

Rishikimi i literaturës

Tregu i sigurimeve është një nga shtyllat kryesore financiare të një vendi, institucion ky i cili gjithashtu u gjend para një pasigurie të shtuar. U bënë shumë studime, kërkime dhe hulumtime, për atë se si do të jetë ndikimi, në llogari të aksionarëve të vetë kompanive të sigurimit, të mbajtësve të polisave dhe vetë tregut të sigurimeve.

Ashtu si çdo pandemi tjetër që ka krijuar hyrje në një krizë ekonomike, edhe fillimi i pandemisë së COVID-19 mund të shkaktoj një krizë të re ekonomike, ishin këto fjalët e punimit të hershëm mbi situatën nga Oravský et al. 2020. Përveç kësaj, duke pasur parasysh natyrën afatgjatë të sigurimit, dhe nivelin e lartë të integritit të sistemit financiar global (Chevallier 2020), kompanitë e sigurimeve janë investitorë të rëndësishëm afatgjatë në tregjet financiare globale.

Literatura akademike mbi efektet e pandemisë COVID-19 në sektorin e sigurimeve është e kufizuar. Babuna (2020) përshkruajnë ndikimin e COVID-19 në sigurim industrinë në Ganë, duke vënë në dukje se kompanitë e sigurimeve po raportojnë rezultate më të dobëta financiare. Shevchuk et al. (2020) zbuloi se COVID-19 mund të jetë katalizatori për inovacionin në sigurime. Më e rëndësishmja, pasi pandemia COVID-19 ka shkakuar pasoja të drejtpërdrejta në ekonominë globale, studiuesit kanë bërë thirrje për hulumtime mbi efektin e pandemisë në sektorin e sigurimeve (Goodell 2020).

EIOPA gjithashtu ka qenë burim informimi dhe analize, me analiza të shumta si “Përgjigja e EIOPA -s ndaj krizës së koronavirusit”,

Siguruesit Evropian përballen me Rritje të Rrezikut për shkak të Covid-19, por Perceptimet dhe Pabarazitë e Tregut mbetën në Medium Level”, ”Ndikimi i Rendimenteve Ultra të Ulëta në Sektorin e Sigurimeve, Përfshirë efektet e para të krizës COVID-19”, ”Deklarata Mbikëqyrëse mbi Njohjen e Aftësisë pague (solvencionit) II të Skemave Bazuar në Risigurim në lidhje me COVID-19 dhe Sigurimi i Kredisë”, etj.

Zakonisht, kompanitë e sigurimeve janë konsideruar me më pak rrezik se bankat sepse ato janë më pak të ekspozuara ndaj rrezikut të likuiditetit (Caporale et al. 2017). Ndërveprimet në rritje midis sigurimeve sektori, tregjet financiare dhe ndërmjetësit e tjerë financiarë, si dhe novacioni financiar, globalizimi dhe çrregullimi i sistemit financiar, kanë bërë operacionet të ndërmjetësve financiarë gjatë dekadave të fundit më komplekse dhe potencialisht më të rrezikshme (Sharpe dhe Stadnik 2007). Baluch et al. (2011) zbuluan se siguruesit e jetës, siguruesit e përbërë globalë, risiguruesit globalë dhe siguruesit e tjerë evropianë ishin më të prekur dhe patën performancën më të keqe gjatë krizës 2007-2008. Hulumtimet tregojnë se kriza financiare 2007-2008 shkaktoi që siguruesit e garancisë financiare të hyjnë në vështirësi financiare, me efekte negative që përhapen tek njësitë ekonomike dhe tregjet që mbështeteshin në këtë sigurim (Drake et al. 2017)

Metodologjia e hulumtimit

Në fushën e sigurimeve kemi shumë autor mbarëbotëror që kryejnë hulumtime për specifika të ndryshme, por në tregun tonë, në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, këto hulumtime janë më të pakta. Si burim të informacioneve janë marrë informatat e shpallura përmes raporteve vjetore nga Agjencia për Mbikëqyrje të sigurimeve të Maqedonisë së Veriut. Këto të dhëna mblidhen në bazë të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, në bazë të cilit janë të rregulluara detyrimet e kompanive të sigurimit kundrejt shtetit dhe mënyra e informimit.


Informatat që vijnë nga të gjithë kompanitë e sigurimit në vend, Agjencia për Mbikëqyrje të sigurimeve i përpunon dhe i publikon në webfaqen e saj. Kryesisht Agjencia paraqet burimin bazë të informatave për tregun e sigurimeve në vend. Të dhënat nga Agjencia janë krahasuar dhe njehsuar në përqindje ndryshimet e tyre gjatë luhatjeve ndër vite.

Komentimi i informatave të gjeneruara nga hulumtimi

Në vazhdim është nxjerrë një grafikoni, në të cilin është paraqitur bruto prodhimin vendor i Maqedonisë së Veriut për vitet 2018, 2019 dhe 2020, shuma të paraqitura në miliardë dollarë. Siç shihet nga grafikoni, në vitin 2018 BPV arrin shifrën prej 12.68 miliardë \$, viti 2019 me 12.55 miliardë \$ dhe viti 2020 12.27 miliardë \$. Në qoftë se e krahasojmë me vitin 2019, BPV i vitit 2020 është më e ulët për 2.3%.

Kjo rënie e BPV në RMV i paraprin tkurrjes ekonomike si pasojë e krizës së shkaktuar nga pandemia.

Graf.1 Prodhimi i brendshëm bruto i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitet 2018-2020



Burimi: Enti statistikor i Maqedonisë së Veriut


Primi i shkruar është një term kontabël në industrinë e sigurimeve që përdoret për të përshkruar shumën totale që klientëve u kërkohet të paguajnë për mbulimin e sigurimit në politikat e lëshuara nga një kompani gjatë një periudhe të caktuar kohore. Primet e shkruara faktor në shumën e primit të ngarkuar për një polisë që tashmë ka hyrë në fuqi, pavarësisht se cilat pjesë janë fituar. Primet e shkruara janë burimi kryesor i të ardhurave të një shoqërie sigurimesh.³

³ Definimi i primit të shkruar

Investopedia <https://www.investopedia.com/terms/w/written-premium.asp>

Fusha e sigurimeve nuk ishte e paprekshme dhe padyshim që pati dhe efektet e saja në treg. Në vazhdim është paraqitur bruto primi i polisuar për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Graf.2 Bruto primi i shkruar në tregun e sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitet 2018-2020



Burimi: Raporti vjetor mbi punën e tregut të sigurimeve për vitin 2020 nga Agjencia për mbikëqyrje të sigurimeve

Nga viti 2018 në vitin 2019 ka pasur një trend rritës, ku nga 9.927.564 mijë denarë është ngritur në 10.582.414 mijë denarë, apo ndryshe e llogaritur 6.6% rritje nga viti i kaluar. Në vitin 2020 përsëri pati rënie të reflektuar, nga 10.582.414 në 10.05.906, apo 4.89% rënie.

Në një kumtesë të Deloitte, një organizatë multinacionale e cila ofron shërbime auditimi, këshillimi, këshillimi financiar, këshillimi për rrezikun, taksat dhe shërbimet ligjore, parashihej që për vitin 2020 do të uleshte numri i kërkesave për dëme sa u përket klasave të sigurimit të automjeteve. Më 4 shkurt të 2021 Ministria e punëve të brendshme doli me deklaratë se në vitin që kaloi, kryesisht viti 2020 kishte pasur një rënie rekorde të numrit të aksidenteve nga viti i kaluar⁴. Të shohim se si ishin dëmet e paguara për këtë periudhë në klasat e sigurimeve të sigurimit të automjeteve si autopërgjegjësi dhe sigurimi kasko. Të shohim bruto primin e shkruar të akumuluar për vitin 2020 dhe 2019 dhe


⁴ Kumtesë nga ministria e punëve të mbrendshme e Maqedonisë së Veriut
<https://mvr.gov.mk/vest/14565>

njëkohësisht të krahasojmë dhe dëmet e likuidura përgjatë kësaj periudhe. Një pjesë e vitit 2020 kaloi në restriksione të lëvizjes për shkak të COVID-19, gjë që ndoshta dhe ka ndikuar në uljen e aksidenteve dhe rënien e kërkesave për dëme.

Në kuartalin e fundit të vitit 2020, në sigurimin e automjeteve, duke përfshirë këtu sigurimin kasko dhe autopërgjegjësini, tregu i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka akumuluar 4.136.297 mijë denarë bruto prim të shkruar në autopërgjegjësi, kurse në vitin 2019 ka akumuluar 4.577.080 mijë denarë. Ky ndryshim në mes të dy viteve paraqet një rënie të akumulimit të bruto primit të shkruar në këtë klasë për 9.6%. Në klasën e sigurimit Kasko të mjeteve motorike, bruto primi i shkruar në vitin 2019 ishte 838.236 mijë denarë kurse në vitin 2020 823.735 mijë denarë, që paraqet një ulje prej vetëm prej 1.7%. Të shohim tani për të njejtën klasë, autopërgjegjësi, lëvizjen e dëmeve të likuiduara ku në kuartalin e fundit të vitit 2020 për autopërgjegjësi, dëmet e likuiduara ishin 1.880.406 mijë denarë, kurse në kuartalin e fundit të vitit 2019 kemi 2.060.176 mijë denarë. Ndryshimi në mes dëmeve të likuiduara për dy vitet, 2019 dhe 2020 paraqet rënie me 8.7% në vitin 2020 krahas 2019.

Një sektor tjetër i prekur mjaft rëndë nga pandemia ishte turizmi. Këtë e shohim edhe nga ndryshimi i pësuar në klasën e sigurimit të ndihmës turistike. Në vitin 2019 kjo klasë ka akumuluar 220,692 milionë denarë bruto premi të shkruar, kurse në vitin 2020 kjo shifër u ul për 65% duke rënë në 76,325 milionë denarë.

Graf.3.Bruto primi i shkruar në klasën e ndihmës turistike nga viti 2015-2020



Burimi: Raportet vjetore mbi punën e tregut të sigurimeve nga Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimeve

Në grafikun e dhënë kemi paraqitur bruto preminë e akumuluar të kësaj klase nga viti 2015 deri në 2020. Nga ajo që është e paraqitur mund të konstatojmë se nga viti 2015 kemi pasur një trend rritës deri vitin 2020 që kishte një rënie të thellë. Deri në vitin 2020 kemi pasur rritje modeste ndër vite, siç është 1.1% rritje nga viti 2015 në vitin 2016; 8.9% rritje nga viti 2016 në vitin 2017; 7% rritje nga viti 2017 në 2018; 3.6% rritje nga viti 2018 në 2019 dhe rënia e thellë me -65% në vitin e fundit, pra vitin 2020.

Conclusion

The pandemic in which the world finds itself brought about a comprehensive crisis. At first the world was faced with many uncertainties and many unknowns. Every activity was closed and the status quo was unknown. The effects of the crisis were felt everywhere in every sector, and will continue to be felt, given the fact that we are still in an unstable epidemiological situation.

The pandemic changed the way we live and work. Many of these implications will be long-term and these changes will follow us even after the end of the pandemic. Companies in every sector, including Insurance, will have to adopt new technologies and new ways of working as they adapt to these new realities.

During this period, there is a decrease in gross domestic production, there is a decrease in gross premium written by the country's insurance companies, there is a decrease in the number of contracts and so on. From the analyzes made in this paper it is seen that in one way or another, COVID-19 has also affected the insurance sector. Gross written premium decreased by 4.89% compared to 2019, making an analysis for the special class of motor third party liability which had a decrease of 8.41% and also a decrease of 9.17% of liquidated claims compared to 2019. Also in the analysis of the tourist assistance class had a 65% reduction in gross written premium, a class that was expected to be severely affected due to numerous restrictions on international travel.

The situation remains unclear, there are stagnations in various areas, there is rising inflation, deficits and other uncertainties, but it remains for the insurance market to follow the situation closely and react a priori to any risk.

Recensentë:

Prof. Dr. Klime Poposki

Prof. Dr. Katerina Najdeska Angeleska

Referenca

1. Agjencia për mbikëqyrje të sigurimeve- “Raporti vjetor mbi punën e tregut të sigurimeve 2020”

2. Babuna, Pius, Xiaohua Yang, Amatus Gyiilbag, Doris Abra Awudi, David Ngmenbelle, and Dehui Bian. 2020 -“The impact of Covid-19 on the insurance industry. International Journal of Environmental Research and Public Health”

3. Oravský, Róbert, Peter Tóth, and Anna Bánociová. 2020 -“The ability of selected European countries to face the impending economic crisis caused by COVID-19 in the context of the global economic crisis of 2008. Journal of Risk and Financial Management”

4. Chevallier, Julien. 2020- “COVID-19 pandemic and financial contagion. Journal of Risk and Financial Management”

5. Caporale, Guglielmo Maria, Mario Cerrato, Xuan Zhang 2017- “Analysing the determinants of insolvency risk for general insurance firms in the UK. Journal of Banking & Finance”

6. Devereux, Michael, Niels Johannesen, John Vella. 2019-“Can taxes tame the banks? Evidence from the European bank levies. The Economic Journal 129: 3058-91”

7. EIOPA 2020-“European Insurers Face Increased Risk Exposures Due to Covid-19, but Market Perceptions and Imbalances Remained AT Medium Level.

8. EIOPA 2020-“Impact of Ultra Low Yields on the Insurance Sector, Including First Effects of COVID-19 CRISIS”

9. EIOPA 2020 “Supervisory Statement on the Solvency II Recognition of Schemes Based on Reinsurance with Regard to COVID-19 and Credit Insurance

10. Zimon, Grzegorz 2020 - “An Analysis of Working Capital Management Strategy in Small Enterprises Operating Within Group”

11. Zimon, Grzegorz 2020 - “Issues of financial liquidity of small and medium-sized trading companies: A case study from Poland Entrepreneurship and Sustainability Issues

12. Zimon, Grzegorz, and Robert Dankiewicz. 2020 - "Trade Credit Management Strategies in SMEs and the COVID-19 Pandemic - A Case of Poland"

13. Zimon, Grzegorz, and Hossein Tarighi. 2021 - "Effects of the COVID-19 global crisis on the working capital management policy"

14. J. Кјосевски - "Влијанието на осигурувањето врз економскиот раст"

15. Babuna, Pius, Xiaohua Yang, Amatus Gyilbag, Doris Abra Awudi, David Ngmenbelle, and Dehui Bian. 2020. The impact of Covid-19 on the insurance industry. *International Journal of Environmental Research and Public Health*

16. Chevallier, Julien. 2020. COVID-19 pandemic and financial contagion. *Journal of Risk and Financial Management*